

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja Teuta Krusha, me pjesëmarrjen e praktikantes Besire Muhamedi, në çështjen penale të akuzuarit A [redacted] nga Prizreni, me numër personal [redacted] për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.2176-4/2016 të datës 30.11.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Shpend Binaj dhe të akuzuarit, me datë 28.08.2018 publikisht morri dhe shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

A [redacted] H [redacted] nga i ati F [redacted] dhe e ëma S [redacted] e lindur Kaçaniku, i lindur më datë 10.03.1971 në Prizren ku edhe tani jeton rruga [redacted] nr.88, ka të kryer shkollën e lartë të ekonomisë, ekonomist, i martuar, babai tre fëmijëve, me numër personal [redacted] shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

ËSHTË FAJTOR

Me datë 14.08.2016 në orët e mbrëmjes rreth orës 18:30 minuta, në Prizreni në lokalën e cila gjendet në rrugën [redacted] për shkak të një mosmarrëveshje dhe konfliktit i akuzuari sulmohet fizikisht nga të akuzuarit B [redacted] J [redacted] dhe T [redacted] J [redacted] dhe merre lëndime të lehta trupore, kështu në gjendje të revoltuar dhe me qëllim që ti kundërvihet të akuzuarve, me dashje përdor forcë ndaj të akuzuarit Tefik Jupaj në atë mënyrë që gjatë fjalosjes e kap për gjoksi dhe e shtynë por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Këso dore ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPK.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49, 50, 51, 73 dhe nenit 187 par.1 të KPK të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Të dëmtuarit B [redacted] J [redacted] dhe T [redacted] J [redacted] që të dy nga Prizreni rruga [redacted] nr.21, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që të paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari të paguaj 30 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Mbikëqyrjen e dënimit me kusht do të bëjë Shërbimi Sprovues në Prizren, në pajtim me nenin 159 par.1 të LESP.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.2176-4/2016 të datës 30.11.2016, kundër të akuzuarit A. H. nga Prizreni, për shkak të veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPK.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, gjykata shpali dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. I akuzuari pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit deklarohet se e ka të qartë, andaj edhe në mënyrë vullnetare ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Ditën kritike me datë 14.08.2016 rreth orës 18:25 minuta, në Prizreni në një lokal i cili gjendet në rrugën [] i akuzuari A. H. për shkak të mosmarrëveshjes me të akuzuarit B. T. J. i njëjti sulmohet dhe merre lëndime të lehta trupore e me qëllim që ti kundërvihet të njëjtëve, me dashje përdor forcë ndaj të akuzuarit T. J. në atë mënyrë që derisa janë fjalosur e kap për gjoksi e shtyn por nuk i shkakton lëndime të dukshme trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar në shqyrtimin fillestar ku i akuzuari, ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, për shkak se cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Mirëpo sipas detyrës zyrtare nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e cila mbështetet në fakte dhe prova materiale, të paraqitura në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 246 të KPPK dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 të KPK dhe për këtë të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit, është i martuar dhe mbajtës i vetëm i familjes, është i gjendjes së varfër ekonomike, pendimi i thellë për kryerjen e veprës penale, premtimin se në të ardhmen do të përmbahet nga veprimet e këtilla, kjo është hera e parë që bie ndesh me ligjin, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht, sepse konsideron se me kërcënim të dënimit do të arrihet qëllimi i dënimit, prandaj i shqiptoi dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nuk kryen veprë të re penale e bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi udhëzimin e dëmtuarve në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri në pajtim me nenin 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.


Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.


Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.2642/2016 të datës 28.08.2018

Praktikantja
Besire Muhamedi



Gjyqtarja
Teuta Krusha



UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.